

**Agreement
between
the Government of the Slovak Republic
and the Council of Ministers of the Republic of Albania
on Gainful Occupation of Family Members of Employees
of their Diplomatic Missions and Consular Posts**

The Government of the Slovak Republic and the Council of Ministers of the Republic of Albania

(hereinafter referred to as the "Contracting Parties"),

Considering the particularly advanced stage of understanding between the two countries; and

With the aim of establishing new mechanisms to strengthen their diplomatic relations;

Agree as follows:

Article 1

1. On the basis of reciprocity, the family members of employees of a diplomatic mission or a consular post may be authorized to engage in gainful occupation in the territory of the receiving State in accordance with this Agreement.
2. The observance of domestic legislation is mandatory for occupations or specialized activities that are subject to the regulations of the receiving State.

Article 2

For the purposes of this Agreement:

1. "A Member of a diplomatic mission or a consular post" means a diplomatic agent or a member of the administrative and technical staff of a diplomatic mission, or a consular officer or a consular employee of a consular post in the receiving State, who is not a national of or a permanent resident in the receiving State.
2. "Family member of a member of a diplomatic mission or a consular post" means:
 - a) a spouse or permanent companion;
 - b) an unmarried dependent child under 21 years of age;
 - c) an unmarried dependent child under 25 years of age, enrolled at a university or higher education institution recognized by the receiving State;
 - d) an unmarried dependent child physically or mentally disabled that is able to perform gainful occupation.
3. "Gainful occupation" means work under an employment contract or under an agreement on performance of work outside an employment relationship. Work of a family member in a diplomatic mission or a consular post of the sending State or other States or a mission to an International Organization is not covered, and is in no way affected, by this Agreement.

4. "Receiving State" means the State of Contracting Party to which the member of the diplomatic mission or consular post is officially accredited and where the seat of diplomatic mission or consular post is located.

Article 3

1. In the Slovak Republic

a) Before a family member is allowed to engage in gainful occupation, the Diplomatic Mission or Consular Post of the Republic of Albania shall request an official authorization, in writing and with the relevant documents, from the Protocol Department of the Ministry of Foreign and European Affairs of the Slovak Republic.

b) Upon confirmation that the family member in question fits the categories defined in this Agreement and taking into account applicable domestic provisions, the Protocol Department shall inform the Diplomatic Mission or Consular Post of the Republic of Albania, by writing and without delay, that the family member is authorized to engage in gainful occupation in the Slovak Republic in accordance with the applicable domestic legislation.

2. In the Republic of Albania

a) Before a family member is allowed to engage in gainful occupation, the Diplomatic Mission or Consular Post of the Slovak Republic shall request an official authorization, in writing and with the relevant documents, from the Protocol Department of the Ministry for Europe and Foreign Affairs of the Republic of Albania.

b) Upon confirmation that the family member in question fits the categories defined in this Agreement and taking into account applicable domestic provisions, the Protocol Department shall inform the Diplomatic Mission or Consular Post of the Slovak Republic, by writing and without delay, that the family member is authorized to engage in gainful occupation in the Republic of Albania in accordance with the applicable domestic legislation.

3. Family members engaging in gainful occupation in the territory of the other Contracting Party are not entitled to exemption from any domestic requirements, procedures or fees which may ordinarily apply to such activities.

Article 4

Authorization to engage in gainful occupation shall terminate when:

- a) its beneficiary ceases to have the status of family member under Article 2 of this Agreement;
- b) the performance of a gainful occupation ceases;
- c) the assignment of the individual on whom the beneficiary is accompanied has terminated.

Article 5

1. Family members who engage in gainful occupation under this Agreement shall not enjoy immunity from the civil or administrative jurisdiction of the receiving State, according to the Vienna Convention on Diplomatic Relations or the Vienna Convention on Consular Relations or any other applicable rule of international law, with respect to all matters arising out of such gainful occupations.

2. In case of a family member who enjoys immunity from criminal jurisdiction according to the Vienna Convention on Diplomatic Relations or the Vienna Convention on Consular Relations or any other applicable rule of international law the provisions establishing such immunity shall be applied with respect to any action or omission originated in the performance of the gainful occupation, the sending State shall carefully consider any request submitted by the receiving State for the waiving of such immunity.

Article 6

1. None of the provisions of this Agreement shall entitle the family members to engage in gainful occupations that, under the legislation of the receiving State, may be performed only by its citizens or may be related to national security.

2. This Agreement shall not imply automatic recognition of evidence of formal qualification obtained abroad. Such recognition can only be granted in conformity with the rules applicable for this matter in the receiving State. In the case of professions requiring special qualifications on the territory of the other Contracting Party, the family member shall not be exempted from fulfilling the same requirements applied to nationals of the receiving State. This Agreement does not imply recognition of diplomas and degrees of studies between the Contracting Parties.

Article 7

A family member who engages in gainful occupation under this Agreement shall be subject to the tax, social security and health regulations of the receiving State for all matters connected with such gainful occupations in that State.

Article 8

1. Disputes between the Contracting Parties regarding the interpretation or application of this Agreement shall be settled through diplomatic channels.

2. This Agreement may be amended by mutual accord between the Contracting Parties. Amendments shall enter into force in conformity with the procedure established in Article 9 of this Agreement.

Article 9

This Agreement shall enter into force on the first (1st) day of the second (2nd) month following the day of receipt of the last written notification through diplomatic channels of the Contracting Parties on the completion of their internal legal requirements necessary for entry into force of this Agreement.

Article 10

This Agreement shall remain in force indefinitely. Each Contracting Party may terminate this Agreement at any time provided that a written notification is given to the other Contracting Party through diplomatic channels. Termination shall have effects six (6) months after the receipt of the notification by the other Contracting Party.

Done at on in two originals, each in the Slovak, Albanian and English languages, all texts being equally authentic. In case of any divergence of interpretation, the English text shall prevail.

For the Government
of the Slovak Republic

For the Council of Ministers of the
Republic of Albania

**Marrëveshje
ndërmjet
Qeverisë së Republikës së Sllovakisë
dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë
Punë të Paguar të Anëtarëve të Familjeve të Punonjësve
në Misionet Diplomatike dhe Postet Konsullore**

Qeveria e Republikës së Sllovakisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë
(në vijim të referuara si "Palët Kontraktuese"),

Duke pasur parasysh stadin veçanërisht të avancuar të mirëkuptimit ndërmjet dy vendeve; dhe
Me qëllim ngritjen e mekanizmave të rinj për forcimin e marrëdhënieve të tyre diplomatike;
Bien dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Mbi bazën e reciprocitetit, anëtarët e familjeve të punonjësve të misioneve diplomatike apo posteve konsullore mund të autorizohen të angazhohen në punë të paguar në territorin e Shtetit pritës në përputhje me këtë Marrëveshje.
2. Respektimi i legjislacionit të brendshëm është detyrues për punë apo aktivitete të specializuara që janë objekt i rregulloreve të Shtetit pritës.

Neni 2

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

1. "Anëtar i misionit diplomatik apo postit konsullor" nënkupton një agjent diplomatik apo anëtar të personelit administrativ dhe teknik të një misioni diplomatik apo një zyrtar/nëpunës konsullor, ose nëpunës konsullor të një posti konsullor në Shtetin pritës i cili nuk është shtetas apo me vendbanim të përhershëm në Shtetin pritës.
2. "Anëtar familjeje i një anëtari të një misioni diplomatike apo posti konsullor" nënkupton:
 - a) bashkëshortin/en ose partnerin e qëndrueshëm;
 - b) fëmijën e pamartuar nën 21 vjeç në ngarkim të diplomatit;
 - c) fëmijën e pamartuar nën 25 vjeç në ngarkim të diplomatit, të regjistruar në universitet ose në institucion të arsimit të lartë të njohur nga Shteti pritës;
 - d) fëmijën e pamartuar në ngarkim të diplomatit që ka aftësi të kufizuar fizike apo mendor edhe që është në gjendje të kryejë punë të paguar.

3. "Punë e paguar" nënkupton punë sipas një kontrate pune apo marrëveshjeje për kryerje pune jashtë një marrëdhënieje punësimi. Puna e një anëtari familjeje në një mision diplomatik apo post konsullor të Shtetit dërgues apo Shteti tjetër ose misioni në një Organizatë Ndërkombëtare, nuk mbulohet dhe nuk rregullohet në asnjë rast nga kjo Marrëveshje.

4. "Shtet Pritës" nënkupton Shtetin e Palës Kontraktuese ku akreditohet zyrtarisht anëtari i misionit diplomatik dhe postit konsullor dhe ku ndodhet selia e misionit diplomatik apo postit konsullor.

Neni 3

1. Në Republikën e Sllovakisë:

a) Para se një anëtar familjeje të lejohet të angazhohet në punë të paguar, Misioni Diplomatik apo Posti Konsullor i Republikës së Shqipërisë kërkon një autorizim zyrtar me shkrim dhe me dokumentet përkatëse nga Departamenti i Protokollit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Evropiane të Republikës së Sllovakisë.

b) Pas konfirmimit se anëtari i familjes në fjalë hyn në kategoritë e përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe duke pasur parasysh dispozitat e legjislacionit të brendshëm në fuqi, Departamenti i Protokollit informon me shkrim dhe pa vonesë Misionin Diplomatik apo Postin Konsullor të Republikës së Shqipërisë se anëtari i familjes autorizohet të angazhohet në punë të paguar në Republikën e Sllovakisë në përputhje me legjislacionin e brendshëm në fuqi.

2. Në Republikën e Shqipërisë:

a) Para se një anëtar familjeje të lejohet të angazhohet në punë të paguar, Misioni Diplomatik apo Posti Konsullor i Republikës së Sllovakisë kërkon një autorizim zyrtar me shkrim dhe me dokumentet përkatëse nga Departamenti i Protokollit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë.

b) Pas konfirmimit se anëtari i familjes në fjalë hyn në kategoritë e përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe duke pasur parasysh dispozitat e legjislacionit të brendshëm në fuqi, Departamenti i Protokollit informon me shkrim dhe pa vonesë Misionin Diplomatik apo Postin Konsullor të Republikës së Sllovakisë se anëtari i familjes autorizohet të angazhohet në punë të paguar në Republikën e Shqipërisë në përputhje me legjislacionin e brendshëm në fuqi.

3. Anëtarët e familjes që angazhohen në punë të paguar në territorin e Palës tjetër Kontraktuese nuk përfitojnë përjashtime nga ndonjë kërkesë e brendshme, procedurë apo tarifë që mund të aplikohet zakonisht për aktivitete të tilla.

Neni 4

Autorizimi për t'u angazhuar në punë të paguar përfundon kur:

a) përfituesi i tij nuk gëzon më statusin e anëtarit të familjes sipas Nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje;

b) ndërpritet kryerja e punës së paguar;

c) përfundon emërimi i individit të cilin e shoqëron përfituesi.

Neni 5

1. Anëtarët e familjeve që angazhohen në punë të paguar sipas kësaj Marrëveshjeje nuk gëzojnë imunitet nga juridiksioni civil apo administrativ i Shtetit pritës sipas Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike apo Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore apo ndonjë rregull në fuqi të së drejtës ndërkombëtare për të gjitha çështjet që lindin nga kjo punë e paguar.
2. Në rastin e një anëtari familjeje që gëzon imunitet nga juridiksioni penal sipas Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike apo Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore apo ndonjë rregulli në fuqi të së drejtës ndërkombëtare, dispozitat që parashikojnë këtë imunitet zbatohen lidhur me çdo veprim apo mosveprim gjatë kryerjes së punës së paguar, Shteti dërgues shqyrton me kujdes çdo kërkesë të depozituar nga Shteti pritës për heqjen dorë nga ky imunitet.

Neni 6

1. Asnjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nuk i jep të drejtë anëtarëve të familjes të angazhohet në punë të paguara që sipas legjislacionit të Shtetit pritës, mund të kryhen vetëm nga shtetasit e vet ose mund të lidhen me sigurinë kombëtare.
2. Kjo Marrëveshje nuk nënkupton njohje automatike të dëshmive të kualifikimeve zyrtare të marra jashtë shtetit. Njohja e dëshmive mund të jepet vetëm në përputhje me rregullat në fuqi për këtë çështje në Shtetin pritës. Në rastin e profesioneve që kërkojnë kualifikime të veçanta në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, anëtari i familjes nuk përjashtohet nga përmbushja e të njëjta kërkesave të zbatueshme për shtetasit e Shtetit pritës. Kjo Marrëveshje nuk nënkupton njohje të diplomave dhe dëshmive të studimeve ndërmjet Palëve Kontraktuese.

Neni 7

Një anëtar familjeje që angazhohet në punë të paguar sipas kësaj Marrëveshjeje është objekt i taksave, sigurimeve shoqërore dhe rregulloreve shëndetësore të Shtetit pritës për të gjitha çështjet që lidhen me punët e paguara në atë Shtet

Neni 8

1. Mosmarrëveshjet ndërmjet Palëve Kontraktuese lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhen me kanale diplomatike.
2. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqim të ndërsjellë të Palëve Kontraktuese. Amendimet hyjnë në fuqi në përputhje me procedurën e përcaktuar në Nenin 9 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas marrjes së Kontraktuese për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10

Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi për një afat të pacaktuar. Secila Palë Kontraktuese mund ta zgjidhë këtë Marrëveshje në çdo kohë, me kusht që t'i dërgojë Palës tjetër Kontraktuese njoftim me shkrim me kanale diplomatike. Zgjidhja e Marrëveshjes hyn në fuqi 6 (gjashtë) muaj pasi Pala tjetër Kontraktuese merr njoftimin.

Nënshkruar në, më në dy origjinale, secila në gjuhën sllovake, shqipe dhe angleze. Në rast mospërputhjeje të interpretimit, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Për Qeverinë e Republikës së Sllovakisë

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë